



INTERNATIONAL MONETARY FUND



Kumtesë për shtyp nr. 18/219
PËR QARKULLIM TË MENJËHERSHËM
[06.06.2018]

Fondi Monetar Ndërkombëtar
Uashington, D.C. 20431 SHBA

Stafi i FMN-së përmbyll vizitën në Kosovë

Kumtesat për shtyp në përfundim të një misioni përfshijnë deklarata të ekipeve të Stafit të FMN-së që paraqesin gjetjet preliminare pas një vizite në një vend. Pikëpamjet e shprehura në këtë deklaratë janë të stafit të FMN-së dhe nuk përfaqësojnë medoemos pikëpamjet e Bordit Ekzekutiv të FMN-së. Ky mision nuk do të pasojë me diskutime në nivel të Bordit.

- Performanca ekonomike vazhdon të jetë solide, por rreziqet fiskale janë rritur.
- Politikat duhet të kenë në fokus kufizimin e rrezikut fiskal për të mbajtur qëndrueshmërinë e buxhetit dhe për të mbrojtur shpenzimet produktive, përfshirë investimet kapitale në sektorët prioritarë.
- Zbatimi vendimtar i reformave strukture vazhdon të jetë esencial për të arritur rritje më të forë dhe të qëndrueshme.

Një mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), nën udhëheqjen e Stephanie Eble, vizitoi Prishtinën në periudhën 30 maj – 5 qershor, për të diskutuar mbi zhvillimet ekonomike të kohëve të fundit dhe perspektivën ekonomike të Kosovës. Në përmbyllje të vizitës, znj. Eble deklaroi si në vijim:

“Performanca ekonomike vazhdon të jetë e fortë, ku rritja ekonomike për 2018 pritet të jetë rreth 4 për qind. Inflacioni mbetet i përmbajtur dhe deficit i llogarisë së jashtme rrjedhëse është ngushtuar, pjesërisht si pasojë e rishikimeve statistikore. Sektori bankar vazhdon të jetë i kapitalizuar mirë, likuid dhe fitimprurës. Ekzekutimi i buxhetit të vitit 2018 është përgjithësisht në binarë: disa mangësi në pjesën e të hyrave dhe tejkalime të shpenzimeve sociale si pasojë e moszbatimit të reformave të skemës së benefiteve priten të balancohen me kursime në fusha të tjera”.

“Përderisa perspektiva afatshkurtë është pozitive, rreziqet fiskale janë rritur. Në këtë drejtim, misioni këshilloi që të mos vazhdohet tutje me projektligjin aktual për kompensimin e mësimdhënësve për shkak të kostove të larta fiskale direkte dhe indirekte që do të ngarkojnë buxhetin për shumë vite dhe tkurrin shpenzimet prioritare; të avancohet me reformat e vonuara të veteranëve të luftës; të mos futen programe të reja të patargetuara të përfitimeve sociale; të përshejtohet ristrukturimi i sektorit të ndërmarrjeve publike për t’ia rikthyer qëndrueshmërinë financiare dhe zvogëluar mosefikasitetet; të hartohet reforma e administratës publike brenda kufijve të rregullës për faturëm e pagave; si dhe të monitorohet

me kujdes dhe të mbahet nën kontroll lëshimi i garancive qeveritare që do të mund të rrisnin ndjeshëm borxhin publik”.

“Në të njëjtën kohë, reformat strukturore për të mbështetur zhvillimin e sektorit privat duhet të përshpejtohen në mënyrë që të arrihet rritja më e fortë dhe e qëndrueshme, për të cilën ka nevojë që ta ulë hendekun e madh të të ardhurave me pjesën tjetër të Evropës dhe për ta adresuar nivelin e lartë të papunësisë. Në këtë drejtim, misioni përsëriti nevojën për të avancuar tutje me zbatimin e reformave në arsim, qeverisje, infrastrukturë, tregun e punës, shëndetësi dhe administratën tatimore”.